



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KRYETARI  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shijak, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**BLERJA E DY AUTOMJETEVE ELEKTRIKE TE REJA PËR TAKSAT VENDORE DHE  
POLICINE BASHKIAKE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**Automjete – 34100000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT:

9.000.000 (nentemilion) lekësh **pa TVSH**

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:** Nga data e nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor..

**BURIMI I FINANCIMIT:** TE ARDHURA NGA BUXHETI I BASHKISE

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbeshtetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas përcaktimeve në Shtojcën 8, pika 1 të DST “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe shtojcës 8 të DST-së.

**2.2.1 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe kestet e maturuara për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe shtojcës

8 të DST-së. Duke vertetuar ne kete menyre qe Operatori ekonomik shlyen detyrimet sipas legjislacionit ne fuqi duke bere shlyerjen e taksave vendore aty ku ushtron aktivitetin dhe ka seline qendrore apo ne ato bashki ne te cilat ka kryer pune te ngjashme dhe ka hapur nipte sekondore duke bere pagese te taksave per aq kohe sa ka operuar me ato n=bashki, sipas ligjit te tatimeve ne fuqi.

## **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

## **2.2 Kapaciteti Teknik:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se **40% e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si; referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik*

2.2.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik duhet ta vertetojë këto duke paraqitur akt-marreveshje/autorizim/kontrate lidhur me kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë vendoset me qëllim që të sigurohet një zinxhir i sigurt dhe i pandërprerë për furnizimin e mallrave objekt kontrate në boshtin: Prodhues / Distributor Prodhuesi – Operator Ekonomik – Autoritet Kontraktor. Kjo kërkesë është një garanci për AK në lidhje me mallrat final të furnizuar, të cilët duhet të jenë tregëtuar dhe furnizuar përmes një prodhuesi të sigurt dhe serioz, dhe që siguron se mallrat janë prodhime origjinale.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike/katalogun të mjetit të leshuar nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të tij, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat konformitetit (të lëshuar nga prodhuesi) për mallrat objekt prokurimi, që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin të përcaktuar në specifikimet teknike

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese licensën me kod VII.3.B1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, udhëzim nr. 1545, datë 29.3.2016 “ shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, të autorizuara nga prodhuesi” neni 2 neni 3 e ne vijim , me anë të këtij kriteri vertetohet që operatorët ekonomikë kanë plotësuar kushtet për të marrë licencën e veprimtarisë “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura”, me kodin VII.3.B.2, në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit, dhe për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes se mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, të autorizuara nga prodhuesi, duhet të disponojnë pajisjet, instrumentet, ambientet e nevojshme, si dhe duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat, sipas udhëzimit, kjo vjen ne reference te sigurise se transportit rrugor .

2.3.6 Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë zerrat objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	Emertimi i produktit	Emertimi kompanise prodhuese	Emertimi i katalogut	KOD i produktit ose nr. Faqes ne katalog
----	----------------------	------------------------------	----------------------	------------------------------------------

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që disponon servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjetit objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij/një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të garancisë së mjetit të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 2 (dy) vit ose 50,000 (pesedhjetë mijë) km.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. **Kjo kërkesë vendoset me qëllim që operatorët ekonomikë të jenë serioze ne permbushjen e detyrimeve te cilat do te marrin persiper, per defekte te mundshme qe mund te shfaqen dhe kane lidhje me prodhimin e mallit dhe zevendesimin pjesisht apo teresisht te pjesev te difektuara, pa faj te perdoruesit***

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar dhe pajisur me dokumentacionin e nevojshem per qarkullim ne RSH.

2.2.6 Operatori fitues duhet te paraqese nje deklarate , ne momentin e shpalljes fitues do te dorezoje garanci per mallrat object prokurimi per 2 vite.

*Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke garantuar ne kete menyre qe Operatori ekonomik do te kryeje transportin e mallrave objekt prokurimi prane ambjenteve te Autoritetit Kontraktor dhe me mjetet e veta ne cdo kohe qe kjo do te kerkohe nga AK sipas nevojave te veta.*

**Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Specifikimet teknike bashkëlidhur janë hartuar nga Njësia e Prokurimit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**